

Version i redaktuar publik i

SHTOJCËS 1 të

**'Parashtrimi të Aktakuzës së rishikuar për konfirmim dhe kërkesave në lidhje
me të', parashtrimi KSC-BC-2020-04/F00004/A01 i datës 18 mars 2020**

Publik



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-04
Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar
Data: 26 prill 2021
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i

Aktakuzës së datës 18 mars 2020

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar, në përputhje me kompetencën e tij sipas neneve 35(2)(i) dhe 38 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") akuzon:

PJETËR SHALËN

për **krime lufte sipas të drejtës ndërkombëtare**, të ndëshkueshme sipas neneve 14 dhe 16(1) të Ligjit dhe për **krime të tjera sipas Ligjit të Kosovës**, të ndëshkueshme sipas Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("Kodi i RFJ-së") dhe neneve 15(1) dhe 16(2) të Ligjit sikurse shtjellohet në vijim:

I AKUZUARI

1. **Pjetër SHALA** gjithashtu i njohur si ('Ujku') u lind më 17 shtator 1963 në Prizren, Kosovë dhe ishte shtetas i Republikës Federale të Jugosllavisë ('RFJ') për të gjitha periudhat që kanë lidhje me këtë aktakuzë. Adresa e fundit e njohur e tij është [REDAKTUAR]. **Pjetër SHALA** ka shtetësinë belge (numri shtetëror [REDAKTUAR]).

2. Për të gjithë periudhat që kanë lidhje me këtë aktakuzë, **Pjetër SHALA** ishte anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ('UÇK'), në anglishte, *Kosovo Liberation Army* ("KLA"). Në 1998, ai shërbeu në UÇK, në Zonën Operative të Dukagjinit, ku u caktua në policinë ushtarake. Pas vajtjes në Belgjikë më pas në 1998, **Pjetër SHALA** u kthye në Shqipëri në fillim të vitit 1999 pas thirrjes së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për mobilizim të përgjithshëm. Me të mbërritur në Durrës, Shqipëri, ai kontaktoi UÇK-në dhe rifilloi shërbimin në UÇK.

(i) PARAQITJE E FAKTEVE

Elementët kontekstualë

3. Krimet që paraqiten në këtë aktakuzë ndodhën në kontekstin e konfliktit të armatosur dhe në lidhje me këtë konflikt në Kosovë midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-

së dhe Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave ('UJ'), njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme ('MPB') dhe grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe të Serbisë.

4. UÇK-ja kishte strukturë komanduese, kontrolloi territor dhe planifikoi e kreu operacione në Kosovë dhe Shqipëri. Luftime të armatosura ku u përfshinë forca të shumta, u zhvilluan para, gjatë dhe pas periudhës që ka lidhje me këtë aktakuzë në vende të ndryshme anembanë Kosovës, ndër të tjera edhe përgjatë kufirit me Shqipërinë.

5. Gjatë pranverës së vitit 1999, forcat e NATO-s kryen bombardime ajrore në Serbi dhe Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, anëtarë të UÇK-së dhe një numër i madh civilësh shqiptarë kosovarë u larguan nga Kosova e shkuan në Shqipëri, ku UÇK-ja në atë kohë kishte objekte dhe personel. Shumë njerëz shkuan në Kukës, Shqipëri, dhe në zonën përreth.

6. Gjatë të gjitha periudhave që lidhen me këtë aktakuzë, UÇK-ja përdori një bazë të UÇK-së në fabrikën e mëparshme të përpunimit të metaleve në Kukës, Shqipëri ('fabrika e metalit në Kukës') për qëllime të ndryshme ushtarake, ndër të tjera, për marrjen, magazinimin dhe shpërndarjen e pajisjeve dhe furnizimeve, regjistrimin e vullnetarëve dhe gjithashtu kjo bazë u përdor si pikë përgatitore dhe tranzitore për anëtarët e UÇK-së që shkonin e ktheheshin nga pozicionet pararojë. Fabrika e metalit në Kukës gjithashtu shërbeu edhe si qendër për ndalimin dhe marrjen në pyetje të personave të cilët dyshoheshin se kishin bashkëpunuar me RFJ-në dhe Serbinë, apo se nuk përkrahnin UÇK-në. Krimet e paraqitura në këtë aktakuzë u kryen nga disa anëtarë të UÇK-së kundër personave të cilët u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës. Viktimat e këtyre krimeve ishin të gjithë shtetas të RFJ-së dhe persona të cilët nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime.

7. **Pjetër SHALA** ishte në dijeni të rrethanave faktike të konfliktit të armatosur dhe të faktit se viktimat ishin persona të cilët nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime.

Format e përgjegjësish penale

8. Afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, **Pjetër SHALA** dhe disa ushtarë, policë e roja të UÇK-së patën të njëjtin qëllim të përbashkët të marrjes në pyetje dhe keqtrajtimit të të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës. Qëllimi i përbashkët përfshinte kryerjen e krimeve si ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme.

9. **Pjetër SHALA** kishte të njëjtin synim për kryerjen e këtyre krimeve së bashku me anëtarët e tjerë të kësaj ndërmarrjeje kriminale të përbashkët ('NKP'). Ndryshe, për **Pjetër SHALËN** ishte e parashikueshme që krimi i vrasjes së paligjshme mund të kryhej nga një ose më shumë anëtarë të NKP-së, ose nga persona të përdorur nga cilido prej anëtareve të NKP-së për kryerjen e krimeve që ngërthente qëllimi i përbashkët. Duke qenë i vetëdijshëm se vrasja e paligjshme ishte pasojë e mundshme e zbatimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së, **Pjetër SHALA** mori pjesë në këtë NKP dhe si rrjedhojë e mori përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë.

10. Ndër anëtarët e tjerë të NKP-së përfshiheshin Sabit GECI me pseudonimin 'Qopa', Xhemshit KRASNIQI, ushtarët e UÇK-së [REDAKTUAR], dhe ushtarë, policë dhe roja të tjerë të UÇK-së të pranishëm në fabrikën e metalit në Kukës. Secili prej anëtarëve të NKP-së, përmes veprimeve dhe mosveprimeve të veta, kontribuoi në realizimin e qëllimit të përbashkët. Ndryshe, disa ose të gjithë këta individë nuk ishin anëtarë të NKP-së, por u përdorën nga anëtarë të NKP-së në kryerjen e krimeve, për realizimin e qëllimit të përbashkët.

11. **Pjetër SHALA** dha kontribut të qenësishëm në realizimin e qëllimit të përbashkët, në një ose më shumë nga mënyrat e mëposhtme:

- a. duke marrë pjesë në kryerjen e akteve për vazhdimin dhe zbatimin e ndalimit arbitrar, ndër të cilat ato që paraqiten në paragrafët e mëposhtëm 15-16;
- b. duke marrë pjesë në kryerjen e akteve të trajtimit mizor dhe torturës, ndër të cilat ato që paraqiten në paragrafët e mëposhtëm 20-23 dhe 26;

- c. duke mos marrë masa adekuate për të mundësuar trajtimin njerëzor të të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës; dhe/ose
- d. përndryshe, duke ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve që paraqiten në aktakuzë, ndër të tjera duke inkurajuar dhe ndihmuar kryesit e krimeve dhe/ose përmes shembullit të tij nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në kryerjen e krimeve.

12. Përmes këtyre veprimeve dhe mosveprimeve, **Pjetër SHALA** dha praktikisht ndihmë, inkurajim dhe/ose mbështetje morale, të cilat patën një ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve të paraqitura në këtë aktakuzë. Ai ishte i vetëdijshëm për gjasën e kryerjes së këtyre krimeve dhe për gjasën e kontributit të tij në kryerjen e këtyre krimeve si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të tij.

13. Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përmendura në paragrafët 15-16, 20-23 dhe 26, **Pjetër SHALA** fizikisht kreu akte për vazhdimin dhe zbatimin e ndalimit arbitrar, akte të trajtimit mizor dhe torturës. Ai kishte synimin e kryerjes së këtyre krimeve dhe/ose, në lidhje me ndalimin arbitrar, veprimi duke pasur dijeni të arsyeshme se veprimi ose mosveprimi me gjasë do të shkaktonte heqjen arbitrare të lirisë.

Arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar

14. Afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, **Pjetër SHALA** dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit GEÇI, Xhemshit KRASNIQI dhe ushtarët e UÇK-së [REDAKTUAR], u hoqën lirinë [REDAKTUAR] personave pa proces ligjor të rregullt në fabrikën e metalit në Kukës. Ata u mbajtën në qeli të improvizuara të ruajtur nga roja të armatosura, u prangosën dhe u lidhën, iu morën dokumentet e udhëtimit dhe paratë dhe iu nënshtruan akteve të trajtimit mizor dhe të torturës, sikurse përshkruhet në paragrafët e mëposhtëm 18-24 dhe 26. Këta persona u arrestuan dhe u mbajtën të ndaluar pa bazë ligjore, nuk u informuan për arsyen e arrestimit ose ndalimit të tyre dhe/ose nuk iu dha mundësia të paraqisnin ankesë për ndalimin e tyre.

15. Më 17 maj 1999, ose rreth kësaj date, **Pjetër SHALA**, së bashku me një anëtar të UÇK-së me pseudonimin [REDAKTUAR] dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, morën pjesë në transferimin e [REDAKTUAR] me roje si dhe duke e kërcënuar me vdekje, nga një vendndodhje në [REDAKTUAR] ose në rrethinën [REDAKTUAR] në fabrikën e metalit në Kukës.

16. **Pjetër SHALA** mori pjesë në akte për zbatimin dhe vazhdimin e ndalimit arbitrar në fabrikën e metalit në Kukës, ndër të tjera nëpërmjet akteve të trajtimit mizor e të torturimit të të ndaluarve, sikurse përshkruhet në paragrafët e mëposhtëm 20-23 dhe 26.

17. Sikurse u parashtrua në paragrafët e mësipërm 9 dhe 12-13, **Pjetër SHALA** kishte synimin dhe dijeninë e nevojshme për krimin e ndalimit arbitrar.

Trajtim mizor

18. Afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, **Pjetër SHALA** dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit GEÇI, Xhemshit KRASNIQI dhe ushtarët e UÇK-së [REDAKTUAR], krijuan dhe mbajtën kushte çnjerëzore të ndalimit në fabrikën e metalit në Kukës. Këto kushte u karakterizuan nga heqja e lirisë pa proces ligjor të rregullt, sikurse përmendet në paragrafët e mësipërm 14-16, dhe ofrim i pamjaftueshëm i ushqimit, ujit, kushteve higjienike dhe sanitare, fjetjes dhe strehimit, dhe të kujdesit shëndetësor.

19. Gjithashtu, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, **Pjetër SHALA** dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit GEÇI, Xhemshit KRASNIQI dhe ushtarët e UÇK-së [REDAKTUAR], në mënyrë të përsëritur keqtrajtuan të ndaluarit në fabrikën e metalit në Kukës si fizikisht, ndër të tjera përmes rrahjes me mjete të ndryshme, po ashtu edhe psikologjikisht, ndër të tjera përmes kërcënimit me vdekje dhe kërcënimit me lëndim të rëndë fizik, frikësimit, poshtërimin, diskriminimit për arsye politike, kanosjes, ngacmimit, marrjes në pyetje dhe dhënies së deklaratave dhe pranimit të detyruar ose nën shtrëngim. Të ndaluarit u keqtrajtuan fizikisht dhe

psikologjikisht në prani të të ndaluarve të tjerë. Disa prej tyre u detyruan të bënin punë krahu gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar.

20. Të ndaluarit në fabrikën e metalit në Kukës rriheshin thuajse përditë. **Pjetër SHALA** nuk mori asnjë masë për parandalimin ose kufizimin e dhunës, ose ndryshe për të ndihmuar ose për të siguruar trajtim njerëzor të të ndaluarve.

21. Më [REDAKTUAR], ose rreth [REDAKTUAR], **Pjetër SHALA** dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Xhemshit KRASNIQI dhe Sabit GEÇI, morën në pyetje dhe keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht [REDAKTUAR] të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës, ndër të cilët [REDAKTUAR]. **Pjetër SHALA** dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së urdhëruan [REDAKTUAR] të rrihnin [REDAKTUAR]. **Pjetër SHALA**, vetë dhe së bashku me disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, rrahën [REDAKTUAR], ndër të tjera me shkopinj të trashë, shufra metali, armë, një shkop bejsbolli dhe thika. Në praninë e **Pjetër SHALËS**, disa anëtarë të tjerë të UÇK-së rrahën dhe keqtrajtuuan [REDAKTUAR]. **Pjetër SHALA** dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së i kërcënuan të ndaluarit dhe i akuzuan si bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe/ose si mospërkrahës të UÇK-së. Një anëtar i UÇK-së e informoi [REDAKTUAR] se ishte dënuar me burgim dhe ekzekutim, edhe pse nuk ishte mbajtur gjykim.

22. Më [REDAKTUAR], ose rreth [REDAKTUAR], Xhemshit KRASNIQI, një ushtar i UÇK-së [REDAKTUAR] dhe **Pjetër SHALA** rrahën [REDAKTUAR]. Më tej, disa anëtarë të UÇK-së i detyruan këta dy të ndaluar që [REDAKTUAR] dhe shtinë kundër tyre me armë automatike duke i plagosur të dy. [REDAKTUAR].

23. Më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, **Pjetër SHALA** Sabit GEÇI, Xhemshit KRASNIQI, ushtarët e UÇK-së [REDAKTUAR], dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, vetë dhe bashkërisht, morën në pyetje dhe rrahën [REDAKTUAR], ndër të tjera me shufra metalike, shkopinj bejsbolli dhe armë. Ndërkohë që rrahjet vazhduan gjatë natës, anëtarët e UÇK-së që morën pjesë në keqtrajtim, shtinë me armë zjarri dhe i plagosën këta të ndaluar. [REDAKTUAR] të ndaluarit vazhduan të rriheshin mizorisht, megjithëse të plagosur me armë zjarri, [REDAKTUAR]. Atyre iu refuzua

ndihma mjekësore adekuate. Brenda 24 orësh pasi ishte plagosur me armë zjarri, [REDAKTUAR] vdiq [REDAKTUAR].

24. Veprimet dhe mosveprimet e përshkruara më lart, të marra veçazi ose së bashku, u shkaktuan viktimave vuajtje ose lëndim të rëndë mendor dhe/ose fizik dhe/ose përbënin cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor. Këto veprime dhe mosveprime shkelën të drejtat themelore të viktimave për liri dhe siguri të personit, për lirinë e lëvizjes, të drejtën e një procesi ligjor të rregullt dhe të drejtën për të mos u diskriminuar për arsye politike. **Pjetër SHALA** dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së u përpoqën t'i detyronin viktimat që të vepronin kundër dëshirës dhe ndërgjegjes së tyre. Si pasojë e trajtimit të tyre në fabrikën e metalit në Kukës viktimat humbën vetëdijen dhe kontrollin e funksioneve trupore, pësuan thyerje eshtrash, u poshtëruan, u shfityruan, u mavijosën keqas dhe iu shkaktuan plagë, u mbuluan në gjak dhe patën pasoja psikologjike dhe fizike që vazhduan pas lirimit të tyre.

25. Sikurse u parashtrua në paragrafët e mësipërm 9 dhe 12-13, **Pjetër SHALA** kishte synimin dhe dijeninë e nevojshme për krimin e trajtimit mizor.

Torturë

26. Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara në paragrafët e mësipërm 18-24, **Pjetër SHALA** dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit GEÇI, Xhemshit KRASNIQI dhe ushtarët e UÇK-së [REDAKTUAR], u shkaktuan viktimave dhimbje ose vuajtje shumë të rënda me synim marrjen e informatave ose deklaratave pranuese, ndëshkimin, frikësimin ose shtrëngimin e viktimave dhe/ose diskriminimin e viktimave, ndër të tjera për arsye politike. Gjatë veprimeve dhe mosveprimeve të lartpërmendura, **Pjetër SHALA** dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit GEÇI, Xhemshit KRASNIQI dhe ushtarët e UÇK-së [REDAKTUAR], morën në pyetje të ndaluarit dhe incizuan deklaratat pranuese të tyre dhe i akuzuan viktimat si bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe/ose si mospërkrahës të UÇK-së.

27. Sikurse u parashtrua në paragrafët e mësipërm 9 dhe 12-13, **Pjetër SHALA** kishte synimin dhe dijeninë e nevojshme për krimin e torturës.

Vrasje e paligjshme

28. Më [REDAKTUAR], ose rreth [REDAKTUAR], disa anëtarë të UÇK-së, midis të cilëve edhe **Pjetër SHALA**, detyruan [REDAKTUAR] dhe shtinë kundër tyre me armë automatike. Më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së, midis të cilëve edhe **Pjetër SHALA**, i rrahën mizorisht [REDAKTUAR] të ndaluar. Ndërkohë që rrahjet vazhduan gjatë natës, anëtarët e UÇK-së që morën pjesë në keqtrajtim shtinë me armë zjarri dhe i plagosën këta të ndaluar. [REDAKTUAR] të ndaluarit vazhduan të rriheshin mizorisht, megjithëse të plagosur me armë zjarri, [REDAKTUAR]. Të ndaluarve iu dha trajtim mjekësor i pamjaftueshëm. [REDAKTUAR] vdiq 24 orë pasi ishte plagosur, megjithëse një mjek i këshilloi anëtarët e UÇK-së se i ndaluari duhej çuar në spital.

29. Sikurse u parashtrua në paragrafët e mësipërm 9 dhe 12, **Pjetër SHALA** kishte synimin dhe dijeninë e nevojshme për krimin e vrasjes së paligjshme.

PARAQITJE E KRIMEVE

30. Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara në paragrafët e mësipërm 13, 15-16, 20-23, dhe 26, **Pjetër SHALA** kreu fizikisht krimet e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe torturës. Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara në paragrafët e mësipërm 8-12, 14-16, 18-24, 26, dhe 28, **Pjetër SHALA** nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në një ndërmarrje kriminale të përbashkët, kreu dhe/ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

31. **Pjetër SHALA** mban përgjegjësi penale individuale për:

Pika 1: NDALIM ARBITRAR në fabrikën e metalit në Kukës, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, KRIM LUFTE, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit, dhe neneve 22, 24, 26, 30 dhe 142 të Kodit të RFJ-së që përmendet në nenet 15(1)(a) dhe 16(2) të Ligjit;

Pika 2: TRAJTIM MIZOR në fabrikën e metalit në Kukës, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, KRIM LUFTE, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit dhe neneve 22, 24, 26, 30 dhe 142 të Kodit të RFJ-së që përmendet në nenet 15(1)(a) dhe 16(2) të Ligjit;

Pika 3: TORTURË në fabrikën e metalit në Kukës, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, KRIM LUFTE, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, dhe neneve 22, 24, 26, 30 dhe 142 të Kodit të RFJ-së që përmendet në nenet 15(1)(a) dhe 16(2) të Ligjit; dhe

Pika 4: VRASJE E PALIGJSHME në fabrikën e metalit në Kukës më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, KRIM LUFTE, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, dhe neneve 22, 24, 26 dhe 142 të Kodit të RFJ-së që përmendet në nenet 15(1)(a) dhe 16(2) të Ligjit.

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokuror i Specializuar

E hënë, 26 prill 2021

Në Hagë, Holandë.